Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/405
Datë: 13.07.2023

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35-2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e në mbledhjen e IV te mbajtur me datë 13.07.2023 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Akreditohet dhe validohet** Instituti Sigurisë për Materie të Rrezikshme dhe Mbrojtja nga Zjarri-ISM , me adresën: Rr. Nazim Gafurri 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 13.07.2023 deri 12.07.2026, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

   1.1 Gjuajtësit dhe Shpërthyesit, Niveli IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 6 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit deri me njëzetekatër (24) kandidatë në një grup, dhe numri i grupeve brenda vitit duhet të jetë 25 grupe. Ndërsa e mësimi praktik nuk lejohet të zhvillohet me më shumë se 8 kandidate ne grup.

   1.2 Gjuajtësit dhe Shpërthyesit , Niveli V sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 7 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit deri me njëzetekatër (24) kandidatë në një grup, dhe numri i grupeve brenda vitit duhet të jetë 5 grupe. Ndërsa e mësimi praktik nuk lejohet të zhvillohet me me shume se 8 kandidate ne grup

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së Instituti të Sigurisë për Materie të Rrezikshme dhe Mbrojtja nga Zjarri - ISM, për validim, akreditim dhe rekomandimeve të dala nga raportet e vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, si dhe raportet e ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi i dërgohet:

1. Institutit të Sigurisë për Materie të Rrezikshme dhe Mbrojtja nga Zjarri - ISM, dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim MUSTAFA

Kryetar KD-së AKK